



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

BASHKIA DURRËS

PROJEKTVENDIM

NR.-----, DATË -----/ 2020

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT, ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 251 M² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 201 M² DHE SIP. FUNKSIONALE. 50 M²), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 5 (PESË) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Për Qiranë”, sipas Relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, Kryetari i bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin për dhënien me qira të ambjentit, me vendodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 251 m² (nga kjo sip. ndërtimi 201 m² dhe sip.funks. 50 m²), pronë e bashkisë Durrës, për një afat 5 (pesë) vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.
2. Ngarkohet Drejtoria Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA DURRËS**

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____/____/ 2020

RELACION

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT, ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 251 M² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 201 M² DHE SIP.FUNKS. 50 M²), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 5 (PESË) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU**

Të nderuar këshilltarë!

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim ka për qëllim fillimin e procedurave për dhënie me qira, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, të ambjentit, me vendodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 251 m² (nga kjo sip. ndërtimi 201 m² dhe sip. funks. 50 m²), pronë e bashkisë Durrës, për një afat 5 (pesë) vjet.

Pasuria që kërkohet të jepet me qira, është pjesë e ndërtesës me emërtimin reparti URT-së, e cila që nga viti 2000 e deri më sot i ka kaluar në administrim bashkisë Durrës, e më pas me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të bashkisë, për t'u përdorur për ushtrimin e funksioneve të veta.

Prej vitesh ky ambjent i është dhënë në përdorim, kundrejt kontratës së huapërdorjes, shoqatës së bukëpjekësve. Aktualisht po sherben si magazinim për pajisjet e shkollave të qytetit, të cilat i janë nënshtruar ndërtimit të ri, apo rikonstruksionit. Aktualisht ky ambjent është i lirëtë.

Rezulton se në adresë të institucionit të bashkisë kanë paraqitur interes për marrjen me qira të këtij ambjenti persona të cilët janë subjekt i tatim taksave. Nisur nga fakti se sipërfaqja e këtij ambjenti që kërkohet të merret me qira është mbi 200 m², të drejtën për t'u shprehur si për dhënie me qira, ashtu dhe për afatin e përdorimit 5 vjet, e ka këshilli bashkiak, ndaj i drejtohem këtij Këshilli për t'u shprehur me vendim. Këtë të drejtë jua jep VKM-ja nr. 54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, i cili përcakton se “... Pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar

të drejtën e përdorimit me qira ose enfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit... Pasuritë shtetërore, që jepen me qira janë: ndërtesat, sipërfaqet funksionale (jo nën ndërtesë), trualli i lirë... Organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore jep me qira sipërfaqe 200 -500 m², deri në 10 vjet....”.

Ndërsa ligji organik i vetëqeverisjes vendore në paragrafin *për të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë* përcakton se “... njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...”.

Neni 54 i ligjit “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, gërma “e”, përcakton se Këshilli bashkiak “... miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve... Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit...”.

Ndodhur në këto kushte, me qëllim sigurimin e të ardhurave për bashkinë, i kërkojmë Këshillit bashkiak që të shprehet me vendim për miratim për dhënien me qira të pronës në fjalë.

Dhënia me qira e pasurisë të sipërcituar zgjidh këto probleme:

- Minimizon sadopak papunësinë.
- Shton të ardhurat në buxhetin e bashkisë.
- Përmirëson objektin nga investimi i pritshëm që do të kryhet nga subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- Ruan objektin nga degradimi (shkatërrimi) si rezultat i mospërdorimit.